

**VENDIM**  
**Nr. 761, datë 2.12.2019**

**PËR DHËNIE TRAJTIMI TË VEÇANTË FINANCIAR ZNJ. DENISA GREKU**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1/a, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Dhënie e trajtimit të veçantë financiar mujor znj. Denisa Greku, në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social, të miratuar sipas ligjit nr.770 datë 11.5.1993.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 nëntor 2019.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**